



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:125038
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05526883

A.C.nr.9140/2021

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi - kryetar i kolegjit, Enes Mehmeti, dhe Hysni Bardheci, anëtarë të kolegjit, në çështjen kontestimore të paditësit F.(H).S, nga Fshati ..., Komuna Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.K., avokat me seli në Komuna Prishtinë, kundër të paditurës (KEK) me seli në Komuna Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim Gezim Berbatovci, në çështjen kontestimore për dëmshpërblimin për shkak të lëndimit në punë, duke vendosur sipas ankesës së përfaqësuesit të autorizuar të të paditurës të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2428/20 datë 09.02.2021, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 25.03.2024, mori këtë :

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë, ankesa e të paditurës (KEK) me seli në Komuna Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2428/20 datë 09.02.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.2428/20 datë 09.02.2021, ndër të tjera ka vendosur si vijon:

“... I. APROVOHET PJESËRISHT SI E BAZUAR, kërkesëpadia e paditësit F.(H).S, nga fshati Fsh, ..., Komuna Fushë Kosovë, DETYROHET e paditura (KEK), sh.a, që paditësit në emër të kompensimit të dëmit, për lëndimet e pësuar në vendin e punës më datës 25.11.2010, t’i paguaj shumat e specifikuara si më poshtë:

Dëmi jo material:

- kompensim, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej3.000 Euro.
- kompensim në emër të frikës shumën prej..... 2.500 Euro.
- kompensim në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësor prej 3% shumën prej900 Euro.

II. REFUZOHET pjesa e kërkesëpadisë përtej shumave të gjykuara dhe atë në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike, në shumë prej 1000 Euro, në emër të kompensimit për frikës, në shumë prej 500 Euro, në emër të zvogëlimit të përgjithshëm të aktivitetit jetësorë në shumë prej 1100 Euro, si dhe në tërësi kërkesa për kompensim në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor për dy muaj në shkallë 100 %, 1000 Euro, dhe në tërësi, kërkesa për kompensimin e demit material në emër të rehabilitimit klimatik në shumë prej 525 Euro, në emër të ndihmës se personit të trete 300 Euro, në emër të ushqimit të përforcuar 200 euro, SI E PA BAZUAR.

III. DETYROHET e paditura, që paditësit ti paguaj edhe kamatën ligjore, për pjesën e aprovuar të kërkesëpadisë duke filluar nga data 09.02.2021 e deri në pagesën e plotë, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1.278, Euro, e të gjitha kërkesat në afat prej 7 ditësh nga marrja e aktgjykimit, e nën kërcenim të përmbaramit ligjor...”.

Kundër aktgjykimit C.nr.2586/10 datë 04.04.2018, të marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, në afat ligjor e autorizuar e të paditurës, ka paraqitur ankesë, për shkak të: shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, që të aprovohet ankesa si e bazuar e të paditurit, të ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.2428/20 datë 09.02.2021 dhe të refuzohet kërkesëpadia e paditësit si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit në seancën e kolegjit, në kuptim të nenit 194 të Ligjit nr.3/L-006 për Procedurën Kontestimore, e ekzaminojë aktgjykimin e shkallës së parë brenda kufijve dhe shkaqeve të treguara në ankesë si dhe duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore dhe gjeti se :

-Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës konstatohet se paditësi F.(H).S, nga Fshati ..., Komuna Fushë Kosovë, ka parashtruar padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me datë 28.03.2011, kundër të paditurës Korporata Energjetike e Kosovës në Prishtinë, për kompensimin e demit.

Gjykata e shkallës së parë me datë 24.06.2016, e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor, me datë 23.09.2016, ka marrë Aktgjykim C.nr.582/11 me të cilin aktgjykim pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit.

Kundër këtij aktgjykimi ka parashtruar ankesë pala e paditur.

Gjykata e Apelit me Aktvendimin Ac.nr.470/17 datë 17.04.2020, e ka aprovuar ankesën e palës së paditur, dhe e ka prishë aktgjykimin e shkallës së parë, dhe lëndën e ka kthyer në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë, në rigjykim e ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor dhe pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor me datë 09.02.2021, dhe pas dëgjimit të palëve në procedurë dhe administrimit të provave ka marrë aktgjykim C.nr.2428/20 datë 09.02.2021, me të cilin aktgjykim e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjyqimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjyqimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ndër të tjera e ka arsyetuar se *“...Gjykata pasi konstatoi rrethanat e rastit duke pasur parasysh dhimbjet e pësuar fizike, e sidomos intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit siç janë vazhdimi i dhimbjeve me intensitet të ultë ende, bazuar edhe në praktikën gjyqësore që i referohet lartësisë së kompensimit për rastet e tilla, vendosi si në dispozitiv të aktgjyqimit në pjesën e aprovuar. Gjykata për paditësin pati në konsideratë të veçantë me rastin e vendosjes dhimbjet e pësuar fizike, sidomos intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, sipas ekspertizës, prandaj sipas një vlerësimi të harmonizuar të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e kompensimit vendosi në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Gjykata vlerëson së shpërblimi i dëmit jo material në të holla (para) nuk është shpërblim i plotë, por është satisfakcion për të dëmtuarit, në këtë kuptim është i drejtë për të...”*

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjyqimit, për arsye se aktgjyqimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe nuk ka shkelje nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Nuk qëndrojnë pretendimet e të paditurës se aktgjyqimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit dispozitivi i aktgjyqimit të atakuar është mjaft i kjashtë, rrjedhimisht edhe i përmbareshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjyqimit duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Në këtë drejtim, në bazë të shkresave të lëndës, gjykata e shkallës së dytë vlerëson se në rastin konkret nuk ka qenë kontestues fakti se paditësi punon tek e paditura e parë dhe se me datë 25.11.2010, rreth orës 08.45, min. përderisa paditësi ka qenë në vendin e tij të punës duke e përcjell kabllon e përçuesit elektrik 6 KV, në ndërimin e parë gjatë zbritjes së shkalleve në makinën e kombinuar, ka rrëshqitur nga shkalla e parafundit ku me që rast paditësi ka pësuar lëndime trupore, si pasojë e të cilit aktiviteti i përgjithshëm jetësor i tij është zvogëluar në shkallën 3%, fakt ky i konstatuar përmes ekspertizave të ekspertëve mjeko ligjor të angazhuar në këtë procedurë.

Po ashtu, në bazë të shkresave të lëndës nuk del të jetë kontestues as fakti se përgjegjësia primare për shkaktimin e lëndimit në punë të paditësit, bie mbi të paditurën, fakt ky i cili është konstatuar për ekspertizës nga lëmia e sigurisë në punë, dhe atë ekspertiza e punuar nga eksperti H.M., në të cilën ekspertizë ndër të tjera thuhet se *“...Shkak i lëndimit janë ngricat sezonale... dhe konform rrezikshmërisë në punë, nuk janë përdorur edhe mjetet personale mbrojtëse...se në këtë rast nuk janë aplikuar në tërësi masat e sigurisë në punë... në pajtim me dispozitat e sipërshënuara dhe ato të nenit nenit 2 parag 1 të ligjit nr.2003/19 për siguri në punë...”*.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar si reale shumën sa i përket vendosjes së kompensimit të paditësit për dëmin material, dhe jo material ku edhe e ka vërtetuar aktgjykimin e atakuar, pasi në bazë të mendimit të ekspertëve mjekësor Dr. A.T. Ortoped, i cili ekspertë ka konstatuar se në bazë të ekzaminimit të jashtëm të paditësit dhe në bazë të dokumentacionit që është prezantuar dhe atë ajo e QE e QKUK e dt.25.11.2010 me nr. prot.38479 si dhe raporteve mjekësorë ka konstatuar se paditësi F.S. si pasojë e aksidentit të punës me datë 25.11.2010, ka pësuar fisurë (krisje) e kokës së radiusit të majtë, natyra e lëndimeve të rënda, po ashtu eksperti ka konstatuar se paditësi nga ky aksident ka përjetuar dhimbje të intensitetit posaqërisht të rëndë në kohëzgjatje prej 20 minuta, dhimbje fizike të intensitetit të rëndë që kanë zgjatur dy ditë, të intensitetit të mesëm 21 ditë, dhimbje të intensitetit të ulët në kohëzgjatje ka sot edhe kësaj dite. Ndihma e personit të huaj ishte e nevojshme në kohëzgjatje prej 28 ditëve, ushqimi i përforcuar ishte i nevojshëm në kohëzgjatje prej 15 ditëve, rehabilitimi fizio terapeutik dhe klimatik ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 21 ditësh. Ndërsa Ekspertja Dr. N.M., Psikiatër, në lidhje me frikën e përjetuar si pasojë e aksidentit në bazë të dokumentacionit mjekësorë si dhe ekzaminimit direkt të paditësit Fatmir Sllamniku, ka konstatuar se paditësi ka përjetuar frikë primare në kohëzgjatje prej disa sekonda, frikë sekondare me intensitet të lartë ka pasur në kohëzgjatje prej 3 ditëve, frikë sekondare të intensitetit të ulët e cila ka zgjatur rreth 12 muaj, gjendje faktike kjo e vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes vlerëson se paditësit i takon e drejta në kompensim të dëmit, duke u bazuar në dispozitat e nenit 182, 183.1 të Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve, si dhe bazuar në nenin 323 të Ligjit nr.03/L-006 për procedurën kontestimore, ku vendosja nga ana e Gjykatës së shkallës së parë është bërë duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, vuajtjet e pësuar për shkak të ndodhjes

së aksidentit, ku shumat e gjykuara në emër të shpërblimit të dëmit jo – material, dhe material, paraqitet si shpërblim i drejtë dhe se shumat e aprovuara paraqesin një formë të satisfacionit të paditësit i cili me këto mjete mund të plotësojë nevojat dhe të mirat materiale të tij.

Se shumat e aprovuara nga Gjykata paraqesin satisfacion për paditësin me rastin e lëndimit në punë, e drejta për kompensim dëmi material, dhe jo material si formë e satisfacionit konstatohet edhe në praktiken gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila në rastin MAŽUKNA v. LITHUANIA- (*Application no. [72092/12](#)*), ndër të tjera ka konstatuar se ka shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane, po ashtu në emër të satisfacionit ka vendosur kompensim dëmi material, dhe jo material në favor të paditësit në rastin Mazuka v Lithuania për shkak të lëndimit në punë, duke u bazuar edhe në Nenin 41 të Konventës Evropiane për të drejtat e njeriut, ku në këtë nen ndër të tjera thuhet se “...Gjykata, kur është e nevojshme, i akordon shpërblim të drejtë palës së dëmtuar....”.

Ndërsa në nenin 31 par.1 të Kushtetutës së Republikës së ndër të tjera thuhet se “...Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave...”.

Pretendimi ankimor i të paditurës se në këtë procedure kontestimore nuk kemi të bëjmë me përgjegjësi objektive apo subjektive të palës së paditur, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që Gjykata e shkallës së parë bazuar në sugjerimet e Gjykatës së Apelit me aktvendimin Ac.nr.470/17 datë 17.04.2020, e ka ftuar ekspertin në seancën e mbajtur me datë 09.02.2021 i cili ekspertë ndër të tjera ka deklaruar se “... Ne ekspertizë janë përshkruar lëshimet përkatësisht mosrespektimi i normave të nenit të Rregullores numër 2005/02 për vlerësimin e rrezikshmërisë në punë dhe lidhur me punën të cilat janë përshkruar edhe normat imperative të cilat e detyrojnë palën e paditur që në këto shtate fatkeqësisht ka bërë lëshime duke filluar nga mospërkujtimi i mjeteve personale të punës të punëmarrësit...”.

Pretendimi ankimor i të paditurës sa i përket shpenzimeve të procedurës kontestimore ky pretendim është i pa bazuar, pasi që pika III e aktgjyqimit të atakuar mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë se shpenzimeve, dhe në pajtim me dispozitat e nenit 452 par. 1, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore.

Nuk qëndrojnë pretendimet për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike pasi që gjykata e shkallës së parë ka pranuar të gjitha propozimet e palëve ndërgjyqësore për administrimin e provave të propozuara nga to me të cilat gjykata i ka provuar faktet vendimtare të çështjes sipas të cilave ka vendosur për themelësinë e kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të pa bazuara pretendimet në ankesë të palës së paditur se Gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, sa i përket lartësisë së kompensimit, pasi vlerëson se shumtat e gjykuara nga Gjykata në shkallë të parë, janë reale duke u bazuar edhe në lëndimet e pësuar nga paditësi.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore të të paditurës, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të Ligjit nr.3/L-006 për procedurën kontestimore, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
AC.nr.9140/2021 datë 25.03.2024

Kryetari i kolegjit - Gjyqtari,
Bujar Muzaqi